



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS

Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha

VENDIM

Nr 2 , Datë 04.07.2014

Për

Miratimin e “Studimit hidroteknik për sigurinë e diges së Liqenit Artificial të Tiranës dhe masat mbrojtese nga diga”.

Në zbatim të pikës dh, neni 4, kreu II, të ligjit nr.8681, datë 02.11.2000, “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin, dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, neni 8, të “Rregullores për sigurinë e digave dhe dambave”, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) dhe Këshilli Teknik i Përherëshëm i Digave (KTPD), me kërkesë të Bashkisë Tiranë me shkresën nr.9380/1 prot, datë 30.06.2014, në mbledhjen e datës 04.07.2014, mori në shqyrtim “Studimin hidroteknik për sigurinë e diges së Liqenit Artificial të Tiranës dhe masat mbrojtese nga diga”, nga projektuesit e firmës “GENER 2” sh.p.k Tiranë.

Mbasi u prezantua “Studimi hidroteknik për sigurinë e diges së Liqenit Artificial të Tiranës dhe masat mbrojtese nga diga”, nga përfaqësuesit e grupit të projektimit “GENER 2” sh.p.k Tiranë, si dhe diskutimet e anëtarëve të Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha, (KKDM),

Vendosi:

Të miratojë “Studimin hidroteknik për sigurinë e diges së Liqenit Artificial të Tiranës dhe masat mbrojtese nga diga”, të paraqitur nga projektuesit “GENER 2” sh.p.k Tiranë.

PERI DISHNICA

KRYETAR